



Njoftim për Aplikim

Program Praktikash profesionale për studente të diplomuara ose në vitin e fundit të studimeve universitare në Shkenca Inxhinierike

Në funksion të objektivit strategjik të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve profesionale në strukturat e ministrisë dhe agjencitë e varësisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar ka nisur zbatimin e projektit “Trajtimi i hendekut gjinor të punësimit lidhur me ndërtimin e rrugëve”, përmes realizimit të një programi praktik për vajzat dhe gratë.

Ky program është i financuar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD).

Në këtë kuadër Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) shpall hapjen e fazës së aplikimeve për programin e praktikës profesionale. Ky program synon nxitjen e përfshirjes së studenteve femra në sektorin e infrastrukturës rrugore.

Kjo është një **praktikë pune e paguar**.

Kriteret e aplikimit

- Studente të diplomuara në ciklin Bachelor ose Master në Universitetin Politeknik të Tiranës – praktikë 6-mujore. (Nëntor 2025 – Prill 2026)
- Studente në vitin e fundit të studimeve universitare në Universitetin Politeknik të Tiranës – praktikë 3-mujore. (Mars – Maj 2026)
- Dorëzimi i CV-së dhe dokumentacionit shoqërues (diplomë, listë notash) në adresën zyrtare të e-mailit: info@arrsh.gov.al
- **Afati i aplikimit deri më datë 17 Tetor 2025.**

Procesi i përzgjedhjes

- Përzgjedhja do të bazohet në meritën akademike, motivimin dhe përshtatshmërinë me fushën e studimit.
- Vlerësimi kryhet nga një komision i posaçëm pranë ARRSH. Kandidatet e përzgjedhura do të kontaktohen për intervistë.

Ky program është një mundësi e çmuar për studentet që synojnë të fitojnë eksperiencë praktike dhe të kontribuojnë në zhvillimin e sektorit të infrastrukturës rrugore në Shqipëri, duke marrë pjesë edhe në vizita në terren për mbikëqyrjen e punimeve aktuale të ndërtimit ose mirëmbajtjes së rrugëve nga ARRSH.